

Sigurimi KASKO



Përmes këtij sigurimi, SIGAL UNIQA mbulon:

- Dëmtimet aksidentale: përplasja e automjetit me një objekt fiks ose të lëvizshëm, përmbysja e mjetit motorik.
- Thyerja e xhamave: thyerja e xhamave të përparmë, të pasmë, anësorë, të tavaneve të hapur, shkaktuar këto nga goditja e një objekti të lëvizshëm.
- Zjarri, rrufeja, eksplozioni: dëmet e shkaktuara nga zjarri, eksplozioni dhe rrufeja.
- Katastrofa natyrore: dëmet e shkaktuara nga stuhia, breshëri, dëbora, tufani, përmytja, vërshimi dhe dëmet e shkaktuara në mjetin motorik nga rënia e objekteve të ndryshme që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore.
- Vjedhja, tentativë për vjedhje: dëmet që vijnë si pasojë e veprimeve të përvetësimit në mënyrë të fshehtë të mjetit motorik të siguruar, nga një ose disa persona i të gjithë automjetit (vjedhje totale) ose i disa pjesëve të tij (vjedhje e pjeshme). Në këtë rrezik përfshihen gjithashtu edhe dëmet si pasojë e veprimeve që kanë synuar vjedhjen e mjetit motorik por që nuk kanë arritu të kryhen.
- Dëmtime në parkim (pa autor) : dëmet që pëson mjeti motorik gjatë qëndrimit i parkuar diku dhe nuk dihet shkaktari i demit.
- Dëmtimi nga aktet keqdashëse: dëmet që shkaktohen nga aktet keqdashëse mbi mjetin motorik të siguruar gjatë qëndrimit ose qarkullimit të tij, duke filluar nga dëmtimet keqdashëse e deri tek dëmtimet dhe akte të tjera përfshirë edhe ato terroriste.

